Adem Zaplluzha

TI MUNDESH NËSE DO

Shtëpia botuese TREND- Prishtinë
2018

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Redaktor:
Albert HABAZAJ

Recensent:
Albert HABAZAJ

Lektor:
Veli Veliu

Ballina:

Bashkim Alushi

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Adem Zaplluzha

TI MUNDESH NËSE DO

Shtëpia botuese TREND-Prishtinë
2018

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Poezi e prodhuar nga hidrocentrali i shpirtit të Adem Zaplluzhës

Parathënie e vëllimit poetik "*Ti mundesh nëse do*" e poetit Adem Zaplluzha

Nga MSc. Albert HABAZAJ, *kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve "Petro MARKO", Vlorë.*

Edhe pse deri në këto çaste që shkruaj këto dy fjalë shoqëruese për lexuesin e librit "*Ti mundesh nëse do*", ende nuk e kam takuar Adem Zaplluzhën, unë e njoh Poetin (nga prurjet e kaltra të shpirtit të tij të bardhë). Adem Zaplluzha është Arusha e Bjeshkëve poetike. Njerëzit që kanë dëshirë të shkruajnë poezi e botojnë synojnë të arrijnë në Malin poetik, të kapin majat e tij. Jo të gjithë arrijnë në mal. Jo të gjithë kapin majën. Është i lartë mali. Ka lugina, brinja, çuka, kodra, shpate, qafa, gryka, gërxhe, thepa. Kreshta është sipër. Poeti Adem Zaplluzha kalëron bujar nga Bjeshkët poetike, sepse prizrenasi ynë ka pirë nga uji i kulluar i Bjeshkëve të Sharrit, ka marrë nga hijeshia e tyre dhe ka prodhuar poezi nga hidrocentrali i

shpirtit të tij me dritë. Kur bëjmë bilancin e krijimit letrar, autori prezantohet me një begati krijuese, qoftë për letërsinë shqipe për fëmijë, qoftë për në atë për të rritur, sidomos në gjininë e poezisë së fushës së letërsisë artistike. Tashmë Zaplluzha ravijëzohet si një përmendore madhështore e gjallë, me dinjitet e në lëvizje për Lulëkuqet e Kosovës, se i dhembin sinorët e Atdheut, se i ka të shenjtë gurët dardanë, se i ka në eshtrën e tij fosilet parake dhe thesaret e Therandës. Vëllimi poetik: "*Ti mundesh nëse do*" është një megametaforë jetësore dardane, gjaku artistik i autorit Adem Zaplluzha, i cili tronditshëm kërkon, proteston e lufton, që hirushja diellore, qysh kur u shfaq jeta në këto troje, të udhëtojë fisnikërisht përpara, veç jo nëpër çitjane të "njerkës", por në krahë të simotrave të saj ballkaniko-europiane; jo "*me këmbët e breshkës*", zvarritur, rraskapitur, zhuritur, por "ballëlart e mal në këmbë", siç na vjen krenarisht jehona e një kënge të bukur.

Profili i autorit është i tejdukshëm. Ai në thelb është lirik. Natyra lirike e tij shfaqet natyrshëm, pa artific, pa bujë, bukur, ëmbël, magjishëm e freskët. Nuk është vështirë të kuptosh, se në rrahjet letrare të autorit ndihen dhe regëtima të fuqishme epiko-lirike, nga që rrënjët e ushqimit të tij poetik janë zënë nga Uji i bekuar i Epikës

legjendare, nga lëngu magjik i Ciklit të Kreshnikëve, nga sherbeti i Baladave popullore shqiptare. Tek autori ynë, vijnë me gurgullimë të këndshme remineshencat mitologjike nga poezia jonë legjendare dhe nuk lënë asnjë grimcë të shijes së lodhur parake. A nuk ngjan si një kreshnik i ri i vargut Zaplluzha, që merr e merr fuqi nga qumështi i zanave të Muzës së krijimit?! Mbi shtratin e sigurt dhe të pazëvendësueshëm të traditës së visareve të kombit, autori ndërton një libër poetik modern, harmonishëm me strukturën e re dhe brendinë e pasur poetiko-estetike dhe etiko-morale, sa kombëtare aq universale. Ky vëllim poetik vjen si një pemë e lartë me tri degë të shëndetshme e 93 gjethe me gjelbërim të përhershëm, si pisha e Bjeshkëve të Sharrit, si dafina për kurorë. Cikli i parë titullohet: "*Çfarë të bëj me këtë heshtje?*", i dyti "*Ti mundesh nëse do*", që është dhe titulli i librit dhe cikli i tretë: "*Më erdhi nga baladat*" kanë një lidhje organike, të brendshme dhe buruese, që rrinë bukur pranë njëra-tjetrës në pemën poetike "*Ti mundesh nëse do*", e cila zbukuron kopshtin e Krijimit shqiptar. Duke lexuar vëllimin me vëmendje dhe kënaqësi, herë-herë autori më sjell vegime drithëruese nga Azem Shkreli, Frederik Reshpja apo Fatos Arapi, të holla, të thella, të imta, delikate, aq sa

siç shkruan vetë "*trishtueshëm vdesin pemët në Atdheun tim të largët*". Por ai është vetëm ai - Adem Zaplluzha. Zaplluzha është njeri, është malësor, është shqiptar, qytetar i botës, e njeh dhe e shkruan botën me të gjitha pamjet, me të gjitha stinët, me natyrën e tij, me të gjitha ngjyrat, me dhembjet dhe dashuritë, me ligësitë e mirësitë, me miqësitë dhe urrejtjet, me veset e virtytet, parë nga të gjitha planet e mundshme si krijues. Ky poet i "ashpër" epik bëhet aq lirik i ëmbël e "fije bari", saqë më shpie tek Lasgushi, por me emrin e tij të përveçëm: Adem Zaplluzha, që di të krijojë dhe fjalë të reja si "*pendla e nositit*", që vjen një perlë në fjalorin tonë poetik, por që ka firmën e tij. Herë-herë Adem Zaplluzha shpërthen si Frederik Rreshpja, saqë, për padrejtësitë njerëzore, për veset zvarranike midis "vedit", është në gjendje të kacafytet edhe me perënditë, se "*kafshuam dhe gurin dhe dheun*". Në luftë me kë? Me njëri-tjetrin. E kush fiton? Bota. I fuqishmi. I padrejti. I ligu. Lufta për ekzistencë - shkruan autori - na shndërroi në bisha. Është lufta për dreqin kjo përgjakje e keqe. Edhe trupëzimin e stinëve, të florës, ideve e botëkuptimeve nuk e realizon si qëllim në vetvete në kërkim të labirinteve formale të poezisë moderne, por duke ruajtur shëndetshëm raportin hierakik të funksioneve që

ka arti poetik. Autori është edhe misionar me krijimin e tij, ku ndjenja dhe mendimi njësohen si shpirt në funksion të mesazheve që do të përçojë tek të "tjerët" e tij, por edhe tek "të tjerët e të tjerëve". Thënë me dy fjalë të autorit, mesazhi poetik për njeriun mund të përmblidhet në shprehjen: "O njeri, njih vetveten, se dashuria tund malet e kap yjet me dorë" . Me vargjet,

mbushur ajër e kaltërsi: *"Vetëm nëse do/ mund të shndërrohesh/ në një shpend të shenjtë./Tek e fundit,/ kështu kanë lindur perënditë"*

morfologjia poetike e Zaplluzhës trupëzohet në paradigmën e krijimit, që merr përmasa universale dhe shërben si start për të nisur maratonën e pandalshme jo vetëm shpirtërore të përparimit dhe mirësisë qytetare me identitetin tonë kulturor.

Vlorë, e enjte, 14 shtator 2017

Cikli i parë
Çfarë të bëjë me këtë heshtje

METEORËT KISHIN VDEKUR

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Ishte premtja e madhe
Kur ma vranë atdheun
Vdekja në një sarkofag prej deltine
Zgërdheshej pranë heshtjes së gjymtuar
Kujt t'i drejtohem
Në këto çaste dhembjeje

Mbrëmë isha në mbretërinë e Olimpit
Nën këmbët e Hyjit Dardan
Qëndronin të gjunjëzuar
Perënditë e të gjitha kohërave
Binte një lloj shiu i padukshëm
Na i lagëte të gjitha kujtimet

Nuk pata se çfarë të bëj
Eca edhe disa vite nëpër shpirtin e galaktikës
Meteorët kishin vdekur
I ngjanin atdheut tim të sfilitur
I ngjanin vdekjeve fantazmagorike
Vetëm fundi i hinores qante në faltore

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Qanin edhe kambanat
Te një kambanore e lashtë dy pëllumba
Bisedonin në heshtje
Për fatin e vrarë të atdheut
Bisedonin për ringjalljen e së nesërmes
Pasi që e sotmja veç kishte vdekur
DERI TE DAULLET E VALLEVE MORTORE

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Kjo lëkurë që rreshket në diell
Ngjason me këmbët e breshkës
Cili evgjit që menatë
Do bëj një daulle të çmendur
E cila s'do të pushoj as të dielave

Ne i përjetuam shumë lloje daullesh
Duke u nisur
Prej atyre të luftërave
Deri te daullet e valleve mortore
Daullet e vdekjeve kur gjarpinjtë ulnin kokën

Ishin dimrat e acartë
Kur flinin tok arinjtë dhe njerëzit
Që instinktivisht
Lëpinin plagët e njeri-tjetrit
Lëpinin deri në alivanosje

Kështu që na mësoi jeta
Të vdesim ose të ringjallemi
Si kryqi i ngulur në mish
Jo për hir të ringjalljes
Por për dashurinë e pastër njerëzore
KISHTE VDEKUR NGA ETJA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Mbrëmë një korb i zi nate
Bisedonte me rrapin e vdekur
Ashtu siç mund të llafoset
Një shpend i egër
Me një rrap që e ka humbur vetëdijen

Kurse nata shtegtonte
Prej një ane
Në anën tjetër të lumit
I cili me shumë se njëmijë vjet
Kishte vdekur nga etja

Një njeri kishte mbetur mes dy lumenjve
Kurse urat ka kohë që ishin thyer
Kush mund t'i ndihmoj në këto çaste
Etjes së mallit
Kush mund t'i ndihmoj ringjalljes së lumit
NUK I NJEH ITINERARET E TRISHTIMIT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Sonte nuk kam se çfarë të bëj
Përpos ta vështroj këtë valle të lashtë
Të meduzave
Një hije e verdhë si një zog i çmendur
Më përcjell në ëndërr

Më është cunguar dora e djathtë
Kurse e majta
Nuk i njeh itineraret e trishtimit
Mbi cilën degë të këtij shelgu të pikëlluar
Ta ndërtoj çerdhen e së nesërmes

Asnjë korb nuk u ul sonte
Mbi kapelën time të grisur
Befasisht ikën nositët
Vetëm një varkë e vdekur
Ka mbetur peng mbi syprinën e ujit

POR GJUMI NË VEND TË HUAJ

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Dikur vonë kuptova se si dhe përse
U veniten lulet në kopsht
Ishte dimër në atdheun tim
Ti nuk kishe mundësi
Të vije deri te kujtesa ime

Kështu dimrat lindin dhe vdesin
Në vend të huaj
Vdesin pa e lënë amanetin e fundit
Në krahët e cilit shtërg
Do e shohim pranverën e sivjetme

Unë nuk kam kohë
Ose diçka tjetër më shtyn
Të mendoj në këtë mënyrë
Të mendoj se sa trishtueshëm
Vdesin pemët në atdheun tim të largët

Më duket se njëqind vjet
Nuk fjeta mbrëmë
I përdora edhe pilulat e mi të gjumit
Por gjumi në vend të huaj
Qenka më i lehtë se pendla e nositit
BASHI DUKEJ SI DEMI I ÇMENDUR

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Plima ishte çmendur
Ne nuk ishim në gjendje
Ta kontrollojmë vetveten
Nuk dinin se a duhet
Ta lëshojmë ose ta tërheqim spirancën

Që ta pyesim në këto çaste kritike
Peshku i artë
Kishte vdekur që në fëmijëri
Asnjë pulëbardhë
Nuk fluturoi mbi kiçin e thyer të anijes

Njeriu dukej si demi i harlisur
Shikonte arenën
Duke ulëritur si bisha e plagosur
Njerëzit ishin të etur për gjak
Shpata e matadorit ngulej në mish

Në dy gjunjë ra nata
Asnjë zë njeriu s'lëshonte fanari
U shkyçën të gjitha dritat
Vetëm një peshk i sëmurë
Kundronte bregun e kundërt të detit

ÇFARË TË BËJ NË KËTË HESHTJE

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Kundërmim plagësh
Ushtari qëndronte në heshtje
Me një ushtë të ndryshkur në dorë
Asgjë nuk dëgjohej
Përpos dënesës së natës

Një zog shtegtar
Ose fati im
I ngjante kukuvajkës
Mbi një degë të thyer molle
Era dëneste si një foshnje e harruar

Çfarë të bëj në këtë heshtje
Gjuhën e cilit shkëmb ta shkuli
S'dua të mej si pema e egër
Nëse është nevoja në këto çaste
Do ulërij tok me bishat e malit
PËLLUMBI QË SILLTE LAJMIN

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Sa qenka e zbrazët kjo natë
Asnjë frymëmarrje
Nuk lëshojnë pemët
Nën hijet e shelgjishteve të pikëlluara
Qenka ulur mortja

Mbrëmë dikush shtroi
Sofrën e tradhtisë
I shtroi edhe dymbëdhjetë lugë
Një zog i fatit ose e fatkeqësisë
Fluturonte mbi rrapin e plagosur

Nuk doli asnjë njeri te sheshi
Arena e përgjakur
Kundërmonte vdekje
Pëllumbi që e sillte lajmin
Në fillim të fluturimit ishte zënë peng

SI EGËRSIRA I KAFSHUAM SINORËT E ATDHEUT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Me qindra shekuj ose mileniume
Përtypem dhe i ripërtypëm
Dhembjet tona
Si ariu polar i shëruam plagët
Dhe sërish mbetëm në fillim të rrugës

Secila histori ishte e padrejtë
Ndaj neve
Ose vet ne ishim kundër vetvetes
Si egërsira i kafshuam
Sinorët e kafshuar e atdheut

Çfarë nuk bëmë për ta vrarë fjalën
E vramë edhe zogun e shenjtë
Asnjëherë nuk ditëm
Ose s ‘deshëm të dimë
Se si mund t‘i mbrojmë sinorët
Ottawë, 23 qershor 2017
NDJENTE DHEMBJEN E IKJES

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Kaloi shtatë dete
E shtatëdhjetë e shtatë shtete
Mbi krah duralumini
Iku vërtik
Si i çmendur fluturoi mbi Atlantik
Njëmijë vjet e la atdheun pas shpine
Por kurrë s'mundi të ikte nga vetvetja

Të mirat dhe të ligat i mori në një trastë
Kujtesën e ngulitur në mish
Kurrë nuk e harroi
Në një fotografi të zbehur
E ndjente dhembjen e ikjes
Sa herë deshi të ikte përtej deteve
Vetveten gjithmonë e pati pranë këmishës

Ottawë, 24 qershor 2017

NJË HIJE E ZEZË MBI KAPELËN E TOKËS

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Si fundosja e anijes
Dëgjohet muzika e luleve
Një trishtil i vetmuar
Qante mbi një degë të mështeknës
Dita në metastazë përpëlitej deri në vdekje

Asnjë njeri s'ishte afër meje
Shembeshin gurtët dhe malet
Një hije e zezë mbi kapelën e tokës
Përjetonte ison e një trishtimi
Kukuvajkat fluturuan nëpër kujtesën e rrapit

Si një hu gardhi me vite qëndrova
Mbi gurët e fshatit
Kryqi im u përdhunua nga ardhacakët
Mbeti vetëm plaga dhe dhembje
Në varret e vjetra qanin qivuret

Kishin ikur edhe lejlekët
Nga atdheu im
Vdekja dukej si një nocion e përditshëm
Duke i shoqëruar patat e egra
Nga varret po ikin edhe kandrat

LUFTA PËR EKZISTENCË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Një pemë e moshuar
Rri ulur në kopsht
Kundron hapësirën e vdekur
Vinjeta me një pamje surrealiste
Qante si foshnja e lënë fatit

Ishte e diela e parë pas takimit tonë
Dasmorët e dehur
Shikonin lisin e prerë
Shikonin se si dënesnin degët e dhunuara
Asnjë fjale s'thoshte trungu

Bënte acar at vit
Që në fillim të pranverës
Një brymë e zezë i dogji lulet
E posa të çelura të qershive
Si kalamaj të uritur qanin trungjet

Ishin imazhet e trishtuara të kohës
Nuk e njihte miku mikun
U bëmë ujqër për njeri-tjetrin
Kafshuam gurin dhe dheun
Lufta për ekzistencë na shndërroi në bishë
NUK LËSHOI ASNJË ZË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Sivjet për Pashkë nuk i ngjyrosëm vezët
Nuk di përse
Por tavolina ku gjithmonë
Qëndronte kofini i mbushur me ngjyra ylberi
Ishte më e varfër për një këmbë gjeli në tra

Kambana e vogël e fshatit
S'lëshonte asnjë zë
Mbi kambanore nuk dyndeshin as mjegullat
Përpos krakëllimave të korbave
Shiu sivjet i ngjante trishtimit

Kurrë më të varfër nuk dukeshin Pashkët
Njerëzit kalonin kokulur
S'guxonin ta shikonin as kishën
Një frike e madhe u kishte hyrë në palcë
Sa që s'na kujtoheshin as emrat e miqve

SHKO KU TË DUASH

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Po deshe mund të ikësh ku të duash
Shko edhe në fund të dynjasë
Por mos harro
Se të gjitha udhët
Sërish një ditë do të të kthejnë në atdhe

Unë nuk kam se ku të shkoj
S‘kam tjetër vend mbi këtë dhe
Këtu do të të pres me tërë dhembjen time
Të gjitha rrugët
Një dite domosdo do kalojnë kah zemra ime

Të thashë dhe sërish po të them
Shko ku të duash
Por rrugët kah do që t’i kalosh
Do të të kthejnë në vendlindje
E cila gjithmonë i pret dhe i përcjellë lejlekët

KËSHTU QË NA SHTYNË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Shtërgjet herë vijnë
E herë largohen nga ky qytet
Mu ashtu siç kanë ardhur
Ikin me nga një trastë në sqep

Më kujtohet kur isha adoleshent
Erdhën ca kazanxhinj
Dhe kurrë më nuk u larguan
U bënë zot shtëpie në shtëpinë tonë

Ne ishim në katin përdhes
Nga respekti ose frika prej të huajve
Lejuam të na urinonin mbi kokë
Me një fjalë ishim të huaj në oxhakun tonë

Me duket se u mësuam me këtë jetë
Çdo gjë na dukej normale
Derisa një ditë nuk e tepruan
Duke i kaluar kufijtë e njerëzores

Kështu që na shtynë
T'ua tregojmë anën tjetër të medaljes
Dhe ua treguam mu ashtu
Siç ditëm të heshtim me shekuj
NËPËR PENXHERE DALIN VASHAT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Ngjyrat më të bukura
Si petale trëndafilash çelin
Stërkalat e shiut
Çelin me qindra spektra ylberesh

Shiu i tejdukshëm
I ylbertë
Zbret nga hojet qiellore
Mbi astarin e blertë të natyrës

Sa herë që toka e zhvesh këmishën
Si nëpër ëndrra çelin pemët
Ngjyrat më të bukura të luleve
Çelin si sytë e zogjve endacakë

Nëpër penxhere dalin vashat
Duken si zanate maleve tona
Dalin e na gjuajnë me shikime
Ngjyrat më të ëmbla të dashurisë
MË DUKET SE ISHTE VETË EVA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Ja atje poshtë te korijet
Po shoh se si lulëzon fëmijëria ime
Nga një pikë loti prej nostalgjie
Rriten detet e tërë dynjasë

Rri mbi kepin e kujtesës
Dhe shikoj një valle lozonjare
Të pikave të shiut
Duke lozur mbi qerpikët e kujtesës

Nga një degë e ngarkuar
Një mollë e skuqur
Bie në tokë
Rrokulliset deri te këmbët e mia

Më duket se ishte vetë Eva
Erdhi me tërë buzëqeshjen e saj
Dhe ma dhuroi bukurinë e pranverës
Ma dhuroi zëzëllimën e lumit të çmendur
SA HERË QË MË MUNGON

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Pema e cila na pret në kopsht
E mbolla në kujtesën time
E mbolla
Kur isha adoleshent
Dhe sot lulëzon me të gjitha ngjyrat e ylberit

Është ajo pemë prej shiu
E cila çdo mbrëmje më përshëndet
Me një pantomimë të përsosur
Të cilën gjuhë
Vetëm unë e kuptoj kur bie shi

Ka shumë pemë të tilla
Që i mbolla në jetë
Të egra e të buta
Dhe prej atyre mes egërsisë dhe butësisë
Që më ledhatojnë çdo mëngjes

Pemët e kopshtit tim
Sa shumë i shëmbëllejnë atdheut
Sa herë që më mungon
Mbështetem për ndonjë pemë të lodhur
Kudo që gjendet nëpër botë

KJO BALADË PAGANE

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Më pëlqen të rri heshtur
Të qëndroj mbi gurin e kujtesës
Kjo baladë pagane
I paska shtatë gjuhë prej luleve

Shikoj se si rritet bari
Gjelbërimi me një kapelë të kuqe
Shikon perëndimin e diellit
Kurse shiu troket mbi xhamat e kujtesës

Sonte asgjë nuk ishte si me herët
Pemët këndonin në kor
Vetëm një këndes në tra
E zgjoi mëngjesin e kotur

Unë isha diku mes ëndrrave të mia
Herë shikoja perëndimin
E herë lindjen e përskuqur
Kurse hëna fundosej pas maleve

Ottawë, 25 qershor 2017

JASHTË DËGJOHET TËRBIMI I ERËS

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Fotografia e grisur
Dy qirinj gjysmë të ndezur
Mbi tavolinën e gdhendur
Një kryq i askujt
Rri ngulur në murin e kujtesës

Jashtë dëgjohet tërbimi i erës
Mbi qiellin e Ottawës
Reve të ngarkuara me dhembje
U dëgjohen shtërzimet
Shi nuk bie ani që qajnë mjegullat e zeza

Gomat e shfryra të automobilit
Kërcasin si protezat në gojë
Asfalti i zi
Duket edhe me i zi në këtë kohë të mjegullt
Kurse rrotat përplasen me pikat e shiut

Ne shikojmë tërë habi dhe i zgërdheshemi
Perëndimit të lodhur
Diku në Afrikë
Kamikazët e vdekjes mbjellin murtajë
Shiu nuk pushon në qiellin e turbullt te Ottavës

SHIRAT KËTU FILLOJNË HERËT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Dy hapa para nesh
S’pushonte kori i bretkosave
Shiu nga kazanët e qiellit
Binte me një rrebesh të tërbuar
Gjelbërimi i vdekur
Këndellej në gjoksin e qytetit

Ne rrugën Highpark nr 77
Një shtërg
Reciton Poemën e Mjerimit
Në shtatë lagje më tej
Dëgjohen fantazmat e KKK
Dëgjohen vigma të trishtuara
Të thirrjeve të plagosura

Shirat këtu fillojnë herët
Dhe me muaj nuk din të ndalën
Kur kthehen shtërgjet nga atdheu
Pa dashje
Përjetojnë ringjalljen e gjelbërimit
Kurse mbi drurët shumëvjeçar
Me mallëngjim qajnë qyqet
THUA SE KISHTE HARRUAR ATDHEUN TIM

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Në vend se t'i shpalosni ungjijtë
Ju jeni duke e mbyllur mendjen
Patriarkët e dhembjes
Po krijojnë me qindra sëmundje
Sa që s'po ndalen dyndjet e shtegtarëve

Mbrëmë hyra në palcën e morfologjisë
Pashë se me ishte tkurrur gjuha
Vetëm pantomima
Ndjente thellësinë e etjes sime
Dhe dëneste si një qilimi i braktisur në faltore

Me nostalgji i shikoj dallgët e lumit Ottawa
Në bashin e një anije gjigante
Si kumritë e atdheut tim
Qanin në kor pulëbardhat
Qanin fatet e shtegtarëve të atdheut

Binte edhe një shi i baltosur
Binte si plumb në flokët e mia të thinjura
Një erë e këndshme kishte marrë udhë
Frynte në disa drejtime asnjanëse
Thua se kishte harruar atdheun tim
AS SOT NUK DIMË SE KUSH JEMI

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Meshat në vendlindjen time
Nuk janë as mish e as peshk
Flenë në një gjumë letargjik
Nuk mund t‘i zgjoj
As zëri i ndryshkur i kambanës
Vetëm çafkat e zeza mund të fluturojnë
Në majat e kambanoreve

Me vite të tëra harruam
Se kush ishim dje
As sot nuk dimë se kush jemi
Një sorrë e keqe
Po na i verbon sytë
Sa që nuk jemi në gjendje
As ta hapim e as ta mbyllim ungjillin

Sa herë më bie ta shikoj qiellin e errësuar
Më kujtohen korbat
Fluturimet kobzeza të mjegullave
As sot nuk prajnë me krakëllimat monotone
Nuk prajnë dhe s’do të prajnë kurrë
Derisa ne jemi të gurëzuar
Mes faqeve të pluhurosura të ungjillit

Cikli i dytë
Ti mundesh nëse do

PUSHUAN EDHE TËRMETET

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Si i çmendur u ula përballë vetvetes
Me tërë forcën e vetëdijes
I ndala të reshurat
Atë ditë frynte një stuhi e tmerrshme
Mbi gjoksin tim i ndala uraganet

Eca edhe njëmijë vjet përballë stuhive
Tërmeteve ua shkula rropullitë
Thanë se çdo gjë mund të arrijë njeriu
Dhe pata mbërrirë atë ditë
T'i përqafoj malet që tundeshin nga dhembja

Për çudi u ndalën stuhitë e pamëshirshme
Pushuan edhe tërmetet
Jashtë te pemët
Po lindte një tjetër diell
Po i ngrohte damarët e ngrirë të shpirtit

Dikur vonë kuptova se përse qante pulëbardha
Përse gjithë ajo vigmë
Mbi kiçin e thyer të anijes
Kurse Ottawa çuditërisht këndellej
Në thellësinë e vetvetes kërkonte gjenezën

KINSE ZOTI QENKA I MARRË E NUK
DI SHQIP

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Atë mëngjes nuk na erdhi dielli
Këndesi i lagjes e kishte humbur itinerarin
Këndonte në një tjetër tra
Një tjetër këngë zgjimi
Sa që ne mbetem me mijëra vjet në gjumë

Po ashtu edhe shiu nuk i shëmbëllente
Shirave të atdheut tim
Më shume dukej i përzier me breshër
Se sa stërkala të thinjura prej uji
Ishte krejtësisht ndryshe nga shirat e zakonshme

Një korb i moshuar me ngashërim qante
Mbi degët e thyera te rrapit
Dielli kishte përjetuar shtatë tërmete
Atë ditë kur pritnim në oborrin e kishës
Të lindte një ungjill i ri

Mbase kot po presim edhe sot
Librat e shenjtë s'dëgjohen në gjuhen time
Të shenjtit në thonjëza
Thonë se duhet të flasim në gjuhë të Hyjit
Kinse Zoti qenka i marrë e nuk di shqip
SHTATËQIND VJET NA U DESHTË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Na vranë e na shanë
Na kryqëzuan mbi një trëndafil të egër
Të reshurat kurrë më
Nuk erdhën në atdheun tim

Shtatë herë nga shtatë dekada
Kaluam nën urat e dhunës
Erërat ishin aq të forta
Sa që gjatë rrugëtimit s'patëm asnjë ngritje

Ju thashë se shtatë herë nga shtatë dimra
Të egër u deshtë të përballojmë
Dhe në fund u takuam me ferrin
Fundi i të cilit nuk shihej askund

I dëgjuam shtërzimet
E shtatë tërmeteve të forta të shpirtit
Shtatë milionë vjet na u deshtë
Ta drejtojmë kurrizin e të qohemi në këmbë
MBI NJË GJETH TË KALBUR

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Udha që nuk përfundon
Quhet vetmi
Mbi një gjeth të kalbur
Noton dielli i plagosur

Kush e vrau mbrëmë hënën
E vraftë Zoti
Nga sytë e zgërlaqur të meteorëve
Mbi njëqind vjet pikojnë dhembjet

Lumi i mbufatur si në ndonjë qivur
E barte kufomën e ditës
Yjet e verbët në procesion
Kishin harruar këngën e meshës
TE KEPI I SHPRESËS

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Kur netët e lodhura
Shndërrohen në kukuvajka
Anijet e vdekura
Fundosen thellë në shpirtin
E lënduar të dallgëve

Peshqit bonjakë notojnë mbi ujë
Te kepi i shpresës
Dalin sirenat
Dhe me padurim presin
Kthimin e marinarëve në mol

Në këtë agoni të pa shpresë
Një meduzë e verdhë
Ndjekur nga oktopodët
U lutej perëndive
Për shpëtim e hyjit dardan

Në bregun e kundërt të mendjes
Dielli qëndron kacule
Dhe shikon me keqardhje
Fundosjen
E anijeve të mëngjesit
QIELLI ISHTE I PADREJTË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Mbi asnjë lule s'do derdhi lot
Sa për ta kaluar urën e kujtimeve
Më mjafton kjo dhembje
Ishte një kohë e kalbur
Kur i ndjemë thellë tërmetet

Nuk dua më të përsëritet
E njëjta dhembje
Mbi flokët e shkulura të erës
Ka kohë që nuk ndalen vetëtimat
Ti nuk ishe pranë meje kur më konvertuan

Qielli ishte i padrejtë
Nuk ishte në anën time
Por as sytë nuk i ktheu kah xhelatët
Nuk dija që ta pështyj në surrat
Qiellin apo konvertuesit e mi

KËNDOJMË DHE DËNESIM

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Janë të pashembullt këngët
Tona popullore
Në të shumtën e rasteve
Këndojmë se si na vranë
Dhe gati asnjëherë
Si e vramë dikë

Nuk guxuam ose s'deshëm
Por gjithsesi
Kurrë nuk u ndalën vajet
E grave dhe të burrave
Duke i grithë fytyrat
Hapnim vare të reja

Ende sot në fshatin tim
Dëgjoj vaje të tilla
Dëgjohen edhe britmat e pemëve
Këndojmë dhe vajtojmë
Mbi vdekjet tona
Deri kur kështu deri kur kështu

Ottawë, 26 qershor 2017

TROKET NË XHAMAT E MËNGJESIT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Mëngjesi i shthurur
Në brigjet e Ottawës bisedon
Me fëmijët e humbur të dynjasë
Dallgët si të çmendura
I përpijnë pulëbardhat
Te moli dënes marinari i dehur

Një anije kozmike
Ngarkuar me jashtëtokësorë
I zbërthen kujtimet
Në dhembje
Era fryn nga jugu
Fryn nëpër kujtesën e dallgëve

Te fanari në anën e kundërt të Ontarios
Quebec i përgjumur
I lanë sytë e zgërlaqur
Me lotin e mërgimtarëve
Kurse shiu i mekur
Troket në xhamat e thyera të mëngjesit

NËN ÇADRAT E PLAGOSURA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Më duket se tepër vonë kuptuam
Ose aspak nuk morëm vesh
Se në fushën e mëllenjave
Ende nuk ka përfunduar beteja

Ushtat dhe kryqet si kalamajtë gjëmojnë
Nëpër fushat e përgjakura
Nën çadrat e plagosura
Me flamujt e grisur lidhen plagët

Grumbuj patash të egra
Fluturojnë mbi varet e qiellit të gjymtuar
Mështeknat tok me shelgjet e pikëlluara
Me lotët e vashave shuajnë etjen e ditës

ISHTE KOHA E DASHURIVE

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Sa herë që renda
Nëpër rrugët e fëmijërisë
Si dromcat e kujtimeve
I mblodha dhembjet

Më kujtohet mështekna
Dhe takimi jonë i parë
Nën gjethet e së cilës
I numëronim fluturimet e zogjve

Ishte koha e mjegullave
Nuk dallonim asnjë lloj plagësh
Nëpër mendimet tona
Fluturonin zogjtë e përgjumur

Kur ndjenim etjen e jetës
Nga shuplakat e gjetheve
Pinim vesën e mëngjesit
Dhe këndonim deri vonë në mbrëmje

Ishte koha e dashurive
Dhe e dhembjeve
Nga plagët e të cilave
Ndërtuam kështjella vuajtjesh
NUK MENIN AS PISKAMAT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Mbi tryezën e shtruar
Mungonte luga e trembëdhjetë
Një trëndafil i posa çelur
I lante sytë
Me lotët e nënave që s'dinin të pushonin

Këto pamje shëmbëllenin
Me rrugën e gjakosur të Golgotës
Nuk menin as piskamat
Atë ditë ndjemë thellë në shpirt
Shkuljen e flokëve të plakave

Ishte një mot i keq
Aq i keq
Sa që s'mund të përshkruhej
Me asnjë fjalë
Moti i dhembjeve të pashëruara

Atëherë për herë të parë kuptova
Se si me aq ngashërim
Mund të qante loti
Qante sa që thyheshin gurtë e stralltë
Në shpirtin e murosur të njeriut

MË PELQENTE HESHTJA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Më duket se i ngjaja
Tokës së djerrë
Nuk kisha asnjë ëndërr
Nga sytë e mi pikonin makthet

Ju thashë se i ngjaja tokës
E cila i kishte humbur ndjesitë
Asnjë pemë nuk rritej
Në shuplakat e rrudhosura të kujtesës

Më pëlqente heshtja
Pantomimën e mësova përmendësh
Një instinkt i lashtë më tregoi
Se çfarë mund të mësoj nga era

Ngjaja me çdo gjë
Por me se pakti
I shëmbëlleja vetvetes sime
Njeriut pa shpresë dhe ëndrra

UNË NUK I DALLOJ NGJYRAT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Të thashë se je një mashtrim optik
Herë të shoh
E herë më kujtohesh
Si ndonjë pikturë e vjetër surrealiste

Nga sytë e tua blu
Derdhen të gjitha liqenet
Mbi shtatin tënd selvi
Marshojnë brushat e piktoreve anonim

Nuk di për fatin tim të mirë
Ose të keq
Unë nuk i dalloj ngjyrat
Gjerat i shoh me shpirtin tim

Nga ty mësova të dashuroj
Por njëkohësisht edhe të urrej
Sa shkojnë bashkë njëra me tjetrën
Dashuria dhe urrejtja

VETËM TI TË MOS MË MUNGOSH

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Le të shkrepin rrufet
Zjarret kurrë të mos ndizen
Në këtë univers
Detet nëse donë le të përmbyten
Nga zemërimet e reja
Kur dënesin peshqit
Vetëm ti të mos më mungosh

Le të bëhen çdo minutë
Tërmete shpirtrash
Bota le të përmbyset
Të mos ketë kurrë të reshura
Le të ndodhin gjërat
Që s'kanë ndodhur asnjëherë
Vetëm ti të mos më mungosh

Le të përsëriten vdekjet
Ringjalljet le të ndodhin
Në çdo shtatë minuta
Ose njerëzit le të shndërrohen
Në bretkosa
Dhe bretkosat në njerëz
Vetëm ti të mos më mungosh

NDOSHTA DUHET QË NESËR

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Ju lutem
Mos më gjuani po me ato gurë
Që ju gjuajtën juve pak më parë
Mbajeni si një kujtim të hidhur
Kini kujdes tmerrësisht që nesër
Do të keni shumë nevojë për to

Gjeni diçka tjetër
Qe u shëmbëllejnë gurëve
Ose le të ju duken si gurë
Por kurrsesi mos mi gjuani ato
Me të cilët
U deshtë të mbroheni ju

Gjuani me çfarë të doni
Nëse doni shkulni dhëmballët e juaja
Por me ato gurë mos gjuani
Kini kujdes
Ndoshta që nesër do të ju duhet
Armiqësisht ta gjuani vetveten

AS UNË ASKUJT NUK I FOLA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Askush s’me foli asnjë fjale
Për lindjen time
Por e di
Qe u linda pa dëshirën time
Nga një pellg gjaku
Dhe gjatë gjithë jetës
Më përcollën lumenj gjaqesh

Asnjëherë nuk e mësova
Artin e puthjes
Në qepallat e thinjura
Edhe sot fare qartë duken
Perdet e trishtuara të teatrit antik
Asnjë puthje nuk ndjeva
Në buzët e zhubrosura të erës

As unë askujt nuk i fola
Për puthjet sekrete
Gjithmonë heshta si gur varri
Nuk di
Ndoshta më pëlqente heshtja
Por gjithsesi
Për mrekulli e mësova artin e durimit

MENDOJMË SE NGA SHIRAT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Ne gjithmonë mendojmë
Se nesër
Mund të përsëriten tërmetet
Shirat e heshtur
Të na kthehen vërdallë

Mendojmë se lumenjtë
Mund të rikthehen te burimet
Ose vetë njeriu
Të kthehet ilegalisht
Në atdheun e stërgjyshërve

Mendojmë se nga shirat
Mund të krijohen mjegullat
Por kurrë nuk mendojmë
Për mënyrën
Se si u krijuan detet
DITA KUR U TAKUAM ME DRITËN

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Ndoshta që nesër
Nuk do të përshëndetemi
Me njëri-tjetrin
Unë do të udhëtoj në perëndim
Kurse ty do të të lë në lindje

Dita kur u takuam me dritën
Udhët tona u ndanë
Secili prej nesh
Kalonte nëpër një vig trishtimesh
Të ndërtuar prej dhembjeve

Të kujtohet kur të thashë
Se ne kurrë nuk jemi takuar
Ti nuk më besove
Andaj kalove në anën tjetër të rrugës
Dhe gjendesh atje duke e ndjekur hijen tënde
NDOSHTA AJO ISHTE ASNJANËSE

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Natën e mirë njerëz
Mirëmëngjesi
Nuk di kur u pamë për herë të fundit
Por ne gjithsesi
Jemi parë diku në ëndrrat tona

Ishte dimër i acartë
Ose pranverë
Por çfarë rëndësia ka stina
Me takimin tonë
Ndoshta ajo ishte asnjanëse

Mirëmëngjesi
Natën e mirë o njerëz
Tani mu kujtua takimi me ju
Ishim mes toreadorëve si marioneta
Në arenën e përgjakur të jetës

TË LUTEM MOS MË LËNDO

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Të lutem mos më lëndo
Mos provo të më lëndosh
Me asnjë fjalë
Sepse fjalët vrasin
Më shumë së plumbat e helmuar

Më kujtohen o fare mirë më kujtohen
Ato shrapnela të hidhura
Kur më plagosën
Për gjithë jetën
Nga trishtimi mbeta si pyka në dru

Më duket se është tepër vonë
T'i mësojmë lutjet
Ose psalmet pagane
Në emër të cilit Zot të të lus
Të mos më lëndosh më asnjëherë
POR DRUAJ SE DO BËHET VONË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Nëse çelin lulet stërkala shiu
Dielli ndryshon itinerarin
Ylberi duket më i varfër
Spektrat e ngjyrave
fundosen në nostalgjinë monotone

Askush më nuk di
Se kah i bie lindja
E ku ka ikur perëndimi
Një kukuvajkë me vite do kukas
Mbi metamorfozën e hapësirës

Ndoshta edhe njëqind vjet
Do presim ndryshimin e motit
Do mësojmë kur është dimri dimër
E pranvera pranverë
Por druaj se do bëhet vonë

Bari do ndryshoj ngjyrën
Do ketë krejtësisht një tjetër pamje
Kurse mjegullat e zeza
Do lëvaren si pjergullat e kuqe
Mbi hapësirën e mërrolur të atdheut
KURSE ANIJET E VETMUARA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Rri ulur
Përballë pasqyrës së vjetër
Shikoj hapësirën përbrenda meje
Shikoj se si dynden zogjtë
Nga të katër anët e dynjasë

Mbi flokët e mia të thinjura
Derdhen lumenjtë
Detet çmenden derisa i përmbysin anijet
Mbi kepin e majtë të bregut
Një sirenë shndërrohet në mjellmë

Oktopodët i kanë ngritur duart
Përshëndesin kthimin e marinarëve
Kurse anijet e vetmuara
Paskan mbetur peng
Në hapësirën e pafundme të Atlantikut
SA QË MBETA PA ASNJË ËNDËRR

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Me kohë kam mësuar
Se ti gjumin e bënë në ëndrrën time
Del lëndinave të etjes
Dhe vrapon në drejtim të agimit
Vrapon derisa këndesat e zgjojnë mëngjesin

Nuk dua të përsëritëm
E as të ripërsëritëm
Por këtë çfarë të them
Është një e vërtetë e mishtë
Gjumin gjithmonë e bën në ëndrrën time

Të kam thënë se nuk me lë rehat të fle
Por kush mund ta zbusë
Kryeneçësinë tënde
Nëse nuk e bën gjumin në ëndrrën time
Ty të ngushtohet frymëmarrja

Të kujtohet kur t'a dhashë
Një pjesë të vogël të ëndrrës
Por pas një kohe
Ti e more të tërën
Sa që mbeta pa asnjë ëndërr

DITA I KA LËSHUAR DIZGJINËT E ERËS

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Përreth meje një botë e shthurur
Dy pëllumba në kornizë
Gugatin duke ftuar agun
Për ta shijuar mjaltin e mëngjesit

Dita i ka lëshuar dizgjinët e erës
Dhe vrapon pas pulëbardhave
Mbi një anije të fundosur
Një sirenë deti vajton fatin e marinarëve

Dallgët e përgjumura pa i çelur sytë
Përplasen nëpër shkëmbinj
Pulëbardhat fluturojnë në drejtim të panjohur
Në horizont dëgjohen britma patash të egra

Ende pa e humbur dielli itinerarin
Këndesat hipin trarëve të kalbur
Presin ta zgjojnë mëngjesin
Të hapin rrugë kthimit të anijeve

Ottawë, 27 qershor 2017

NË HORIZONT NJË VARKË E THYER

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Nëpër ajrin e dendur
Dhe të tendosur
Fluturojnë fluturat delikate
Në oborrin e vjetër te pemët
Era ndjen tundimin e fjalës
Pas meje si nëpër balada
Dëgjohen këngët mortore

Çfarë të bëj me heshtjen time
Në rropullitë e mi
Dëgjohet zëzëllima e furtunës
Detet veç paskan fjetur
Asnjë balenë blu
Sot s‘doli në gjueti
Taverna te moli përkundet në gjumë

Dallgët herë ngritën e herë ulen
Të pushojnë në mëshirën e furtunës
Në horizont një varkë e thyer
Ua zgjatë dorën pulëbardhave
Erdhën në ndihmë edhe sirenat
Por fundosja
Ishte ndoshta e domosdoshme
SOT NË BRIGJET E EGRA TË LUMIT
OTTAWA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Shko ku të duash
Kalo në daç edhe në anën tjetër
Të dynjasë
Por spirancën kurrë mos e lësho
Në shpirtin e ndonjë atdheu anonim

Mos se të ngufat nostalgjia
Ajo është një plagë
Që kurrë nuk iu gjet dot shërimi
Mund të shndërrohesh në shtërg
Por kurrë mos e harro itinerarin e fluturimit

Sot në brigjet e egra të lumit Ottawa
Takova një hije të lodhur duke biseduar
Me pulëbardhat e thinjura
Pashë edhe një spirancë të shkulur
Nga zemra e së cilës pikonte ADN-ja e atdheut
ISHA NË GJENDJE TË KACAFYTEM
EDHE ME PERËNDITË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Me të gjitha ngjyrat e ylberit
Mbrëmë i lustrova këpucët
I kapërceva me një kërcim
Malet më të egra të atdheut

Nëpër ujërat e çmendura
Notova si me një varkë prej përralle
Kravatën e lidha për bishtin e hënës
Njëkohësisht isha poet dhe lypsar

Nuk lejova askënd të hyj
Mes meje dhe dashurisë sime
Të gjithë pohuan se jam poet i çmendur
Që i kalëron kuajt e egër të stepave

Nga këmisha ime thura ëndrrën tënde
Me velat e saja
Pashë më pashë e kapërceva Atlantikun
Bëra të xhelozojnë edhe marinarët e dehur

Nëpër tavernat e molave
Si Frederik Rreshpja u kacafyta me të dehurit
Askujt nuk ia lëshova rrugën
Isha në gjendje të kacafytem edhe me perënditë

NËPËR SHTIGJET E NJË ËNDRRE

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Ishte tretënata e një zhgjëndrre
Me një çafkë në dorë
Ngrita dolli me malet
Ngrita
Për shëndetin e atdheut
Dhe të gjyshërve të mi dardanë

Si të dashurën time
I përqafova të gjitha detet
Nëpër shtigjet e një ëndrre
Eca edhe njëqind vjet
Me lopata prej mjegulle
Kalova neper itineraret e Uliksit

Rruga ime quhej fillim
Askund nuk i shihej fundi
Për shtatë ditë e shtatë net
Kalova mbi syprinat e shtatëqind deteve
Por sonte mu deshtë shumë pak
Për të mbërri deri në Itakë
KAH PIKON LOTI I VESËS

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Momente të pafundme
Jaseminët po fishken në kopsht
Një trishtil me zërin mallëngjyes
Po e zgjon ëndrrën e trishtuar nga gjumi

Degët nudo ende po flenë
Bari disi i trullosur shikon habitshëm
Se si nga putrat e maces së egër
Po pikon loti i vesës

Dielli mashtrues po fshihet
Pas mjegullave
Nuk prajnë as krakëllimat e korbave
Ky mëngjes mbase dhunshëm po zgjohet

Ju thashë se çaste të pafundme
Po ringjallen në mua
Shikoj se si zgjohet dhe fishket gjelbërimi
Kurse varfëria e diellit shndërrohet në iluzion
TI MUNDESH NËSE DO

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Po deshe çuni ti mundesh
Me i prek yjet me dorë
Me i shalua
Kuajt me të egër të dynjasë
Ti mundesh edhe diçka më tepër
Të jesh vetvetja e jote

Po deshe të kuptosh provo njëherë
Se çfarë fuqie ka dashuria
Ka aq fuqi të madhe
E cila mundet
Me një shikim të vetëm
Me i tund të gjitha malet

Ti mundesh nëse do
Me tejkalua edhe vetveten
Vetëm nëse do
Mund të shndërrohesh
Në një shpend të shenjtë
Tek e fundit
Kështu kanë lindur perënditë

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Ende nuk është vonë
Tepër është herët
Për ta provuar dashurinë tende
Të thashë se ti mundesh
Të mbërrish të pamundurën
Vetëm duhet të duash mu atë
Çfarë do dhe dëshiron shpirti yt

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Cikli i tretë
Më erdhi nga baladat

KËSHTJELLË E PAMPOSHTUR

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Atdheu im ti je kala
Asnjëherë e pushtuar nga jashtë
Nën bedenat e tua
Pushojnë eshtrat e gjyshërve dardanë
Pushojnë
Për t'u ringjallur sërish nesër

Ah ajo e nesërmja
Si një flutur e plagosur fluturon sinorëve
U del përballë dredhive
Që të mos pushtohesh nga brenda
Atdheu im
Kështjellë e pamposhtur e gjyshërve të mi

ME QINDRA POEZI TË PAPËRFUNDUARA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Qershori i vonshëm
Kanë mbetur edhe disa ditë
Për ardhjen e gushtit
Ajo hyri në dhomën time
Dhe u shndërrua në një bust antike

Me shikonte në heshtje
Nuk bëzanin as trëndafilat
Pamja ime e ngrysur tregonte
Se ishte tepër e vonshme ardhja e saj
Për çfarë më duhen tani puthjet e zbehta

Shikoj si një copë të akullt mermeri
Ajo më kundron në mënyrë habitore
Mbi tavolinën time
Me qindra poezi të papërfunduara
Presin të ringjallen

Mbrëmja tani është në ikje
Gjumi m'i ka mbyllur qepallat e syve
Me një pamje indiferente
Duket si mbretëresha në fron
As nuk zgjohet e as nuk largohet
MË JEP VETËM AQ

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Asgjë më shumë
Nuk kërkoj nga ty
Më duaj me zemër
Sa e do vetveten tënde

Më jep vetëm aq
Sa mund t'i japësh vetvetes
Sa shumë kam nevojë sonte për ty
Në këto çaste delikate

MË DUHET NJË LLUPË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Sa pak gjera më kanë mbetur
Për sonte
Një poezi e papërfunduar më pret
Mbi tavolinën time të punës
Dhe ty me ta urua natën e mirë

Për shkak të pamjes sime të errësuar
Më duhet një llupë
Që t'i lexoj gënjeshtrat e ditës
T'i dëgjoj lajmet dhe ngjarjet
Që do të ndodhin një tjetër ditë

Nuk më kujtohet dreka e sotme
Por më kërcasin zorrët
Uria ka filluar me i gërrye rropullitë
Gotën e verës që e përpiva
Më duket se ishte e prishur

Për shkak të rrymës
Nuk i dëgjova gënjeshtrat e mbrëmjes
Me ikën lajmet
Thua se nuk ka ngjarë asgjë sot
Në celular më dukej i largët zëri i shokut

NJË HËNË E RE LOZONJARE

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Një hënë e re lozonjare
Dhe një trëndafil në vazo
Po ngjiten në qiell
Dielli i mbrëmjes fundoset pas maleve

Asnjë yll në hapësirë
Një korb nga degët e akacies
Kundron peizazhin e ngrysur
Meteorët kryeneç bredhin pa itinerar

Nuk di a thua vallë është vjeshtë
Ose dimri po troket në xhama
Ky peizazh i verdhë
Po ma përkujton stinën e vdekjes

Sapo filluan të bien disa vrizma shiu
Ndoshta do shpëtojnë vazot nge thatësira
Një hënë e re lozonjare
Dhe një vazo prej deltine po ngjiten në qiell
PAPANDEHUR ZURE NJË DREQ

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Si tani më kujtohet
Kur bisedonim për dashurinë
Ti pohoje se i adhuron perënditë
Po çfarë deshe nga unë
Nga një poet rebel dhe endacak
Qe i urren lindjet e zotave

Më duket se ishte koha
Kur derdheshin yjet
Në drejtim të tokës
Ti e mbushje përparësen tënde
Duke besuar
Se do të zësh një perëndi

Ishin më se të kota
Dashjet e tua
Ëndrrat e pa ëndërrta
Në vend se ta zësh një zot
Në përparësen tënde për fat të keq
Papandehur zure një dreq
NGA MJEGULLAT SHTRYDHËM

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Dimrat ishin të paparashikueshëm
Acari gjithmonë trokite në mëngjes
Nëpër muret e vjetra
Ngjiteshin kërmijtë
Asnjëherë s'na lejuan ta hamë bukën e pjekur

Ishin kohërat kur hejet
Pikonin në shpirt dhe gjakun tonë
Nga mjegullat shtrydhëm
Dy gllënjka ujë
Dhe tejpërtej shkretëtirës kaluam atë ditë

Më duket se kurrë më pemët
Nuk çelën lule
Gjethet e fishkura dukeshin si gazeta të shqyera
Më mirë me thënë
Sa shume i shëmbëllenin hartës së atdheut tim
DERI ATJE KU PIQEJ KAFEJA NË RËRË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Sa e sa herë më kanë rrëfyer
Pleqtë e fisit dhe të mëhallës
Se gjyshin tim e morri nata
E morri dhe e degdisi
Diku larg
Deri atje ku piqej kafeja në rërë

Asnjëherë nuk na erdhi asnjë letër
Telegramet ishin luksi i kohës
Kurse zarfet
I kontrollonte një dorë e hekurt
Dhe lexoheshin publikisht nëpër sheshe
Nga përkthyesit shqipfolës

Gjyshi im dritë pastë në atë botë
Se botën reale e kënaqi
Duke shkuar nëpër luftëra për të huajt
Pas njëqind viteve
Arriti një zarf i mbyllur
Me emrin dhe mbiemrin e gjyshit tim shehit

Ottawë, 28 qershor 2017

Shehit - Dëshmor

NË DHOMËN E ERRËSUAR BIE BORË

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Thellë qenka fundosur sivjet
Miku im në vetvete
Vetëm thinjat e flokëve i shihen
Nën shiun e dimrit rri në heshtje
S'bisedon me askënd
Në dhomën e errësuar bie borë

Në dorë i mban disa zarfe të kaltra
Sa shumë ngjanin ato letra
Fluturave të fëmijërisë
Kujtimet i vijnë vërdallë
Ditët si dallgët e egra
Përplasen nëpër muret e kujtesës

Bora s'pushon në dhomën e fjetjes
Ca vrizma shiu spërkasin të kaluarën
Nga e cila s'mund të ik askush
Para dy viteve
I ka ikur edhe gjumi
Pasqyra e pllakosur fle në heshtje
KUPTOVA DHEMBJEN E BABAIT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Një ditë e në një kohë
I vendosa në raftin e vjetër
Fjalët e vdekura
I vendosa edhe letrat e dashurisë
Asnjëherë më zogjtë nuk fluturuan mbi çati

Në atdheun tim të dërmuar
Dimrat ishin të acartë
Bora e kuqe nuk prante së reshuri
Erdhën ardhacakët
Dhe të trokiturat kurrë më nuk reshten

Më duket se atë vit
Desh vdiqa nga xhelozia
Im at ndjesë pastë më shumë e ledhatonte
Kondakun e pushkës
Se sa të vetmin djalë që e kishte

Dikur vonë kur ia behu pranvera
Kuptova dhembjen e babait
Kuptova se sa shumë e donte atdheun
Sa që një ditë shkoi pas fluturave
Dhe kurrë më nuk u kthye
MË ERDHI NGA BALADAT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Rri në një heshtje relative
Preki zëzëllimën e mushkonjës
Një gjinkallë e shqetësuar
Këndon mbi kokën time

Pranë meje asnjë flutur
Më kanë humbur nga kujtesa
Edhe zarfet e kaltra
Çfarë të lexoj në vetminë time

Dera dhe dritaret
Si gjithmonë janë të hapura
Sonte nuk troket njeri i gjallë
Mbase paskan vdekur edhe fluturat

Një zog i lashtë shumë i lashtë
Me erdhi nga baladat
Erdhi dhe sërish u zhduk
Ashtu siç po zhduket kujtesa ime
NJË LYPËS JETON NË MUA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Të jesh poet do të thotë
Njëkohësisht
Të jesh edhe perëndi
Unë nuk jam as njëri
E as tjetri

Sa herë që i shkundi mendimet
Më shkunden edhe stinët
Një ditë jam lypës
Kurse ditën tjetër zog
I cili fluturon hapësirave

Dikur vonë rikthehem në vetvete
Meditoj për gjelbërimin
Poetin dhe mbretin
Por gjithsesi
Një lypsar ende jeton në mua

Te jesh poet do të thotë
Njëkohësisht
Të jesh edhe perëndi
Unë nuk jam as njëri
E as tjetri
NËN RITMIN E NJË KËNGE

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Sa je e bukur
Nën ritmin e kësaj kënge
Ti dukesh po aq delikate
Një flutur e verdhë
Rri ulur mbi flokët e tua gri

Në oborr po bien ca vrizma shiu
Po bien si perënditë
Ti moj perëndeshë e lindur
M'i largove të gjitha dhembjet
Nga sterra më nxore në dritë

Nën ritmin e një kënge
U pamë për herë të parë
Në sytë e tua delikate
Pashë lindjen e pranverës
U takova me oreolin e dashurisë

Kurrë më nuk ndodhën tërmetet
Ti dhe kënga prej uji
I përqafuat me afsh
I përqafuat me dashuri
Si sirenat në kepin e imagjinuar të shpirtit
LE TA NGROHIN MALLIN TIM

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Kam të ftohte
Lëri të ndezura zjarret e dynjasë
Të thashë
Kam shumë të ftohtë
Po ngrihet acari në shpirtin tim

Kjo stinë e luleve
Asgjë të mirë nuk solli
Një gjëmë e padëgjuar
Uturin në mua
Uturin si Drini i Bardhë

Lëri duart e tua të mëndafshta
Në përqafimin tim
Ndoshta do më ngrohin pakëz
Mos harro kyçi të gjitha dritat
Se më paska verbuar kjo natë

Nuk kam aq shumë kohë
Jam në fund të udhës
Lëri të ndezura zjarret
Me nxehtësinë e huazuar nga dielli
Le ta ngrohin mallin tim

M'I MBYTE TË GJITHA PRANVERAT

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Erdhën furtunat e zeza
Mbi kokën time kaluan shumë dimra
Kur të pritja nën hijen e rrapit
Si thuprat e çelikta
Më dridheshin duart

Të thashë nën hije
Sepse dielli e kishte anashkaluar
Gjeografinë e shpirtit tim
Erdhën tufanet e rrepta
Dhe m'i mbytën të gjitha fluturat

Kush nuk kaloi këndej pari
Përpos teje
Kaluan turma derrash të egër
Gra të bukura qe mi merrnin mentë
Por ti kurrë nuk erdhe

Por ti kurrë nuk erdhe
Me lë me dimër në shpirt
M'i mbyte të gjitha pranverat
Tani më ka mbetur vetëm rrapi
Dhe hija vrastare e pritjes
ZBRITE NGA ËNDRRAT E TUA

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Mbështete kokën tënde
Mbi gjoksin tim
Mbështete të lutem edhe fjalën
Derisa zgjohet këndesi i agimit
Sonte do t'i numërojmë yjet

Nuk di se në cilën kohë u takuam
Athua vallë ishte dimër
Ose fillimi i pranverës
Por ne gjithsesi u pamë në një stinë
Kur lulet çelnin dashuri

Të kujtohet kur të thashë
Se ti je perëndeshë
Nga turpi i lëshove krahët poshtë
Zbrite nga ëndrrat e tua
Mbështete kokën për gjoksin tim

Flokët e tua të gështenjta
I ngjanin luadheve të adoleshencës
Me kokë të mbështetur për gjoksin e erës
Askush asnjëherë
Nuk ka ditur të ëndërroj më bukur se ti
NEVE VEÇ NA ZURI DIMRI

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Sa shpejtë na u rritën djemtë
E morën dynjanë në sy
Patën aq shumë besim në vetvete
Sa që fluturuan përtej oqeaneve

Sa herë që na merr malli për ta
I nxjerrim albumet nga sirtari
Dhe deri vonë në mbrëmje
Çmallemi si fëmijë me të kaluarën

Neve veç na zuri dimri
Thinjat e flokëve janë rritur aq shumë
Sa që nuk ka gërshërë të mirëfilltë
Qe mund t'i shkurtoje sa duhet

Ndoshta kështu është më mirë
Ata u rriten krijuan familje
Dhe presin një ditë si ne që pritem
Që fëmijët e tyre ta marrin dynjanë në sy
EDHE PAK MË KA MBETUR

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Kjo kohë e shirave stoikisht
Qëndron ndanë meje
Qëndron
Dhe i numëron të bëmat e mia

Nga të katër anët e botës
Po frynë një furtunë e padëgjuar
Here bie shi
E herë shtreza m'i shtrëngon nofullat

Më lodhën dhe më dërmuan stuhitë
Gjate tërë jetës
Më sulmuan pa mëshirë
Me të gjitha llojet e sëmundjeve

Siç po shihni jam në fund të rrugës
Edhe pak më ka mbetur
Të mbërri në cak
Te varret e reja ku e ndërtova shtëpinë

Ottawë, 29 qershor 2017

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu

në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Disa kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, kryesisht me poezi, që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri" më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe të pendës, themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në kuadër të punës së këtij grupi letrar, qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Muresha. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë

1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 – 1995, nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.
Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT
1.“Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.

2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.

3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4.“Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997

5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000

6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007

9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o“Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008

11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.

14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.

15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
3o.“Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
33.“Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010

34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35.“Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011

40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011

41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
44. “Mirëmëngjesi Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
91.”Krakëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. “Stina asnjanëse”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
102. “Një grusht dashuri”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015

120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “ Nëpër brigjet e kujtesës” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016

134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
138. “Nuk i them uinë dot kësaj liri” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
14O. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
141.“Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016

142.“Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.
143.“Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
144.“Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017
145.“Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
146.“Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
147.“Një stinë delikate”, poezi,

Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2017
148."Te ullishtat e vjetra ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë. 2017
149."Ishim të lumtur si gjinkallat",
poezi, Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2017
150."Pikëllimet e rrënjëve", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë. 2017
151."Telat e shirave " poezi, Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2017
152."Një stuhi prej bryme", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë. 2018
153."Sonte s'ka dashuri " poezi, Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2018
154."i shëmbëllente pluhurit kozmik", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë. 2018
155."Llamburite atdheu i plagosur" poezi, Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2018
156."Gurët e pjekura shtatë herë" poezi, Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2018
157. "Kur të dalë nga kjo stinë" poezi, Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2018
158."Ishin thyer të gjitha urat " poezi, Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2018
159."Gjethi i këputur në vjeshtë " poezi, Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2018
16o."Ti mundesh nëse do ,poezi Shtëpia Botuese TREND", Prishtinë, 2018

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Përmbajtja

Cikli i parë
Çfarë të bëjë me këtë heshtje

Meteorët kishin vdekur
Deri te daullet e valleve mortore
Kishte vdekur nga etja
Nuk i njeh itineraret e trishtimit
Por gjumi ne vend te huaj
Bashi dukej si demi i çmendur
Çfarë të bëjë me këtë heshtje
Pëllumbi që sillte lajmin
Si egërsira i kafshuam sinorët e atdheut

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Ndjente dhembjen e ikjes
Një hije e zeze mbi kapelën e tokës
Lufta për ekzistence
Nuk lëshoi asnjë zë
Shko ku të duash
Kështu që na shtynë
Nëpër penxhere dalin vashat
Më duket se ishte vetë Eva
Sa herë që më mungon
Kjo baladë pagane
Jashtë dëgjohet tërbimi i erës
Shirat këtu fillojnë herët
Thua se kishte harruar atdheun tim
As sot nuk dimë se kush jemi
Cikli i dytë
Ti mundesh nëse do

Pushuan edhe tërmetet
Kinse Zoti qenka i marre e nuk di shqip
Shtatëqind vjet na u deshtë
Mbi një gjeth të kalbur
Te kepi i shpresës
Qielli ishte i padrejtë
Këndojmë edhe dënesim
Troket në xhamat e mëngjesit
Nën çadrat e plagosura
Ishte koha e dashurive
Nuk menin as piskamat

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Më pëlqente heshtja
Unë nuk i dalloj ngjyrat
Vetëm ti të mos më mungosh
Ndoshta duhet që nesër
As unë askujt nuk i fola
Mendojmë se nga shirat
Dita kurrë nuk u takuam me dritën
Ndoshta ajo ishte asnjanëse
Të lutem mos më lëndo
Por druaj se do behet vonë
Kurse anijet e vetmuara
Sa që mbeta pa asnjë ëndërr
Dita i ka lëshuar dizgjinët e erës
Në horizonte një varkë e thyer
Sot në brigjet e egra te lumit Ottawa
Isha ne gjendje të kacafytem edhe me perënditë
Nëpër shtigjet e një ëndrre
Kah pikon loti i vesës
Ti mundesh nëse do

Cikli i tretë
Me erdhi nga baladat

Kështjellë e pamposhtur
Me qindra poezi të papërfunduara
Me jep vetëm aq
Më duhet një llupë
Një hënë e re lozonjare

Adem Zaplluzha Ti mundesh nëse do

Papandehur zure një dreq
Nga mjegullat shtrydhem
Deri atje ku piqej kafeja në rërë
Në dhomën e errësuar bie bore
Kuptove dhembjen e babait
Më erdhi nga baladat
Një lypës jeton në mua
Nën ritmin e një këngë
Le ta ngrohin mallin tim
Mi mbyte të gjitha pranverat
Zbrit nga ëndrrat e tua
Neve veç na zuri dimri
Edhe pak më ka mbetur